



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Nr. 543/15 Prot.

Tiranë, më 23.09.2020

**UDHËZUES PËR MASAT HIGJIENO SANITARE NDAJ COVID-19  
PËR AKTIVITETIN E PISHINAVE NË AMBJENTE TË MBYLLURA**

Ky udhëzues përcakton kriteret bazë për hapjen e aktivitetit të pishinave në ambientet e mbyllura gjatë periudhës së pandemisë për shkak të COVID-19 dhe synon të sigurojë një drejtim të qartë e orjentues.

*\*\*Rekomandimet e udhëzuesit mund të rifreskohen në varësi të ndryshimeve të situatës epidemiologjike të qarkullimit të SARS COV-2 në vend.*

*\*\*Evidentimi qoftë dhe i një rasti të vetëm në strukturat e pishinave të mbyllura do të sjellë mbylljen e aktivitetit pavarësisht hetimit epidemiologjik.*

***Të dhëna të përgjithshme***

- Administratori i subjektit/pishinë në ambient të mbyllur paraqet ndaj klientëve grafikun përkatës për organizimin e orëve të aktivitetit në këtë strukturë.
- Administratori i subjektit/ pishinë në ambient të mbyllur, njofton klientët për ardhjen afër orarit dhe jo më parë orarit të përcaktuar.
- Për çdo rast Administratori njih mënyrën e njoftimit apo të lajmërimit për çdo rast të dyshuar COVID-9 gjatë aktivitetit të pishinës.
- Nëse konstatohet nga stafi rast i dyshimtë me shenja të ngjashme me COVID-19, klienti detyrohet të kthehet në shtëpi dhe lajmëron menjëherë mjekun e familjes, si dhe stafi

njofton administratorin i cili njofton strukturat përkatëse të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.

- Asnjë klient me temperaturë 37.5 nuk duhet të lejohet të hyjë në subjekt/ pishinë në ambjent të mbyllur.
- Subjekti duhet të afishojë listën e simptomave të COVID-19 sipas checklistës së miratuar.
- Subjekti duhet të afishojë posterin informues mbi uljen e riskut të COVID-19 sipas formatit të miratuar.
- Materialet informuese afishohen në hyrje të subjektit si dhe në vende të dukshme në brendësi të subjektit, dhe në sektorin e veshje- zhveshjes, dusheve apo tualeteve.
- Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment, higjienizues të duarve me mbi 60% alkool. Dezinfektimi i duarve kryhet menjëherë pas ardhjes dhe largimit nga subjekti; si dhe stafi para dhe pas çdo klienti që i shërbehet.
- Subjekti duhet të sigurojë vazhdimisht dhe me mjetet e tij në çdo moment sapun të lëngshëm, letër për pastrimin e duarve, dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve si dhe kosha mbeturinash të mbyllur të cilët duhen pastruar herë pas here.
- Kapaciteti maksimal i pishinës në ambjent të mbyllur do të bazohet në zënien e hapsirës 3 m<sup>2</sup> për person në pishinë.
- Në çdo rast të sigurohet ventilim (ajrimi) natyral të paktën 5 herë në ditë.
- Subjekti duhet të kryejë dezinfektim të ambjentit larje para hapjes, gjatë funksionimit të paktën 3 herë në ditë dhe pas mbylljes. Sipërfaqet e papastra lahen fillimisht me ujë dhe sapun e më pas dezinfektohen me produktet e tjera.

#### ***Ambjentet e veshje - zhveshjes / tualete***

- Të sigurohet letër për pastrimin e duarve, dezinfektantë për duart dhe për pastrimin e sipërfaqeve si dhe kosha mbeturinash të mbyllur të cilët duhen pastruar shpesh.
- Peshqirët duhet të jenë individual, të sillen nga vetë klienti dhe të përdoren vetëm nga një person.
- Gjatë hyrjes në dhoma e veshje –zhveshjes, duhet të ruhet distanca fizike mbi 1, 5 m dhe stafi të garantojë të mos krijohet fluks i frekuentueseve të pishinës.

- Të sigurohet higjienë maximale në tualet dhe pajisja me të gjithë elementët bazë higjienik dhe të menxhohen në kohë mbetjet.

### ***Ambjenti i pishinës së mbyllur***

- Personeli trajnues (trajnerët personal) duhet të mbajnë në çdo moment maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën në zonën jashtë pishinës. Mundësisht instruktimi të kryhet me elementë apo objekte ndihmëse.
- Të reduktohet numri i trajnerëve personal në të njëjtën orar dhe në të njëjtën pishinë duke respektuar distancimin fizik.
- Klientët duhet të mbajnë në çdo moment maskën mbrojtëse në zonat rreth pishinës duke mbuluar hundën dhe gojën.
- Shenja shtesë në lidhje me distancimin fizik duhet të vendosen rreth zonës së ambjentit të pishinës.
- Kapaciteti maksimal i pishinës do të bazohet në zënien e hapësirës 3 m<sup>2</sup> për person.
- Uji i pishinës duhet të pastrohet në mënyrë sistematike dhe të detyrueshme me sistem filtrimi.
- Nëse do të ketë vende ulëse në grup, një vend midis dy vend ulëseve duhet të qëndrojë bosh për të respektuar distancimin fizik.
- Të evitohen grumbullimet e skuadrave apo grupeve të notit, mbledhjet të stafit etj
- Në rastet e aktiviteteve të skuadrave të notit të merren parasysh korsi të alternative, për shembull, duhet të kryejnë not në një drejtim për korsi.
- Të reduktohet koha e mësidhënies apo e praktikave mësimore për fëmijët që frekuentojnë pishinat e mbyllura.
- Të reduktohet numri i përgjithshëm i klasave të aktivitetit të notit në përputhje me sipërfaqen e pishinës 3 m<sup>2</sup> për person në një interval kohe të përcaktuar paraprakisht.
- Të mos përdoren paisje apo objekte stervitore të përbashkëta në grupet e notit ose duhet të dezinfektohet çdo pajisje e përbashkët e secilës klasë kur zhvillohet praktika mesimi për grupe noti.

- Të kryhet klorinimi i pishinës në mënyrë sistematike sipas protokolleve standarte të mirëmbajtjes dhe funksionimit të pishinave.

Shërbimi i gastronomisë, fast food, ratorante dhe bar kafe do të ndjekë udhëzuesin higjierno sanita, për këto subjekte në ambiente të mbyllura

### ***Pastrim dhe higjenizimi***

- Të kryhen procedurat strikte të pastrimit, ajrosjes dhe desinfektimit të sipërfaqeve.
- Të gjitha vendet e uljes, tavolinat, vendet e depozitimit të sendeve personale, objektet mbështetëse stërvitore duhet të dezinfektohen sipas orëve të përcaktuara të largimit të frekuentuesëve të pishinës së mbyllur.
- Nëse ka një rast COVID-19 në subjekt, operatori do të ndjekë të gjitha udhëzimet për pastrimin larjen dhe desinfektimin e të gjithë zonës së subjektit.
- Përsa i përket vetilimit të ndiqet protokollin anti COVID-19.

### ***Kujdesi ndaj ndihmës së parë***

Në rast incidenti të mundshëm përkundrejt kryerjes së aktivitetit në pishinë, duhet të ndiqen në mënyrë strikte rregullat e kontrollit të infeksionit përkundrejt COVID-19 kur duhet të jepet ndihma e parë ndaj një klienti në strukturën e subjektit pishinë në ambient të mbyllur.

**DREJTOR**

**Albana FICO**

